

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

PASQYRA E PUNËS

POZICIONI I PUNËS	DREJTOR I DREJTORISË SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE
SEKTORI	DREJTORIA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE
ADRESA E QSPA	RRUGA “SKËNDERBEJ”, PLL. 8/3, KATI 5, AP. 40, TIRANË
RAPORTON TEK	DREJTORI EKZEKUTIV

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DREJTORIT TË DREJTORISË
SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve janë:

- Drejtimi, organizimi dhe zhvillimi i kërkimeve dhe studimeve të thelluara në lëmitë e ndryshme të spektrit arbëresh;
- Organizimi i punës për botimet e parashikuara për vitin kalendarik;
- Hartimi dhe integrimi i planeve institucionale afatshkurtër dhe ata afatgjatë, në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv dhe me studiuesit;
- Përgatitja e informacioneve periodike në lidhje me realizimin e aktiviteteve të planëzuara dhe paraqitja e tyre te Drejtori Ekzekutiv;
- Koordinimi i punës për organizimin e konferencave dhe seminareve shkencore dhe bashkërendimi i punës për realizimin e tyre, sipas kalendarit të veprimtarive vjetore;

KANDIDATI DUHET TË PLOTËSOJË KËRKESAT E POSAÇME SI VIJON:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;

EDUKIMI DHE TRAJNIMET

- Të ketë profil studiuesi me titull “Doktor i shkencave” në shkencat sociale të aplikuara, parapëlqehet specialiteti në antropologji kulturore;
- Të ketë kryer studime në fushën e tij/saj të specialitetit;
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e studimeve në disiplinën përkatëse;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor dhe botime (artikuj shkencorë, konferenca) në disiplinën përkatëse mbi kulturën arbëreshe;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj (Italisht ose Anglisht).

AFTËSITË

- Aftësi drejtuese, koordinuese, interpretuese, vendimmarrëse;
- Të ketë aftësi bashkërenduese në punën midis sektorëve të Qendrës,
- Aftësi pune në grup;
- Komunikim shumë i mirë;
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion.

KUSHTET E PUNËS

MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambientet e përshtatshme dhe të mirë organizuara për punën kërkimore e studimore.

ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16:30.
Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës;
2. Jetëshkrim (CV) në formatin EuroPass;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje të diplomave universitare dhe të gradës/titujve shkencorë “Doktor i shkencave”;
5. Referencë nga të paktën një profesor;
6. Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë;
7. Kopje të monografisë/ve, artikujve, konferencave, projekte shkencore etj, që kanë lidhje me spektrin arbëresh por jo vetëm;
8. Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj;
9. Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore;
10. Vërtetim të gjendjes gjyqësore
11. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës 14/10/2024 ora 16:30, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në Rruga “Skënderbej”, pll 8/3, Ap.40, Tiranë, si dhe në adresën e e-mail: info@qspa.gov.al

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.
- Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- VKM nr. 601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Faza e parë:

Në fazën e parë kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

Faza e dytë: Intervista e strukturuar me gojë

Intervista e strukturuar me gojë do të realizohet në datë 16.10.2024 në ambjentet e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurrimit

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet, pas zhvillimit të intervistës me gojë (nëpërmjet adresës së e-mail).